



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1627/6 prot.

Tiranë më 04.11.2022

**VENDIM**

**Nr. 44, datë 04.11.2022**

**PËR KONTROLLUESIN “ALBPETROL SH.A.”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “ALBPETROL SH.A.” (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 154, datë 26.09.2022, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit nr. 21 datë 30.07.2020 (në vijim, “Rekomandimi”) të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kontrolluesin “ALBPETROL SH.A.”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete kohore, mbi përcaktimin e kohës së ruajtjes së të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 5 të ligjit, në përmbushje të pikës 1 të “Rekomandimit”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin

për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale, për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin ato janë mbledhur. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

2. Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale nëpërmjet publikimit të *“Politikave të Privatësisë”* në faqen zyrtare të internetit, në përmbushje të pikës 3 të *“Rekomandimit”*.

Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale nëpërmjet faqes online të internetit, ka detyrimin që të informojë subjektet e të dhënave nëpërmjet *“Politikës së Privatësisë”*.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, dhe konsiderohet mos përmbushje e detyrimit për informim të sanksionuar në nenin 18 të Ligjit. Në këtë kuadër, publikimi i rubrikës *“Politikat e Privatësisë”* në faqen zyrtare të Kontrolluesit përmbush më së miri qëllimin e informimit përkundrejt subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë dhe ngarkojnë të dhëna personale në faqe.

3. Konstatohet se kontrolluesi nuk ka marrë masa për përfshirjen e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, në përmbushje të pikës 4 të *“Rekomandimit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një kontratë tip, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi.

Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunim të ligjshëm të të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të ligjit dhe rregullohen me aplikim e parashikimeve të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit.

4. Kontrolluesi nuk ka marrë masa në lidhje me përditësimin e Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit, dhe në përmbushje të pikës 5 të *“Rekomandimit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat Kontrolluesi është përgjegjës sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi nuk ka marrë masa në lidhje me hartimin e rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen, në zbatim të nenit 27 të ligjit, dhe në përmbushje të pikës 7 të *“Rekomandimit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe të plotësimit të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47 i Komisionerit, në zbatim të nenit 27 të ligjit, dhe në përmbushje të pikës 8 të *“Rekomandimit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 1627/4 prot., datë 10.10.2022.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, dhe me shkresën nr. 7651 prot., datë 21.10.2022, Kontrolluesi parashitroi argumentet si më poshtë:

- Lidhur me konstatimin: *“Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate kohore sipas parashikimeve të nenit 5 të Ligjit..”*, Kontrolluesi argumenton se: *“Albpetrol Sh.A.” mbetet i paqartë se ku duhet ti parashikojë afatet kohore”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se konstatimi i referohet mos përmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandimin nr. 21 të Komisionerit, datë 30.07.2020 për Kontrolluesin *“Albpetrol SH.A.”*.

- Lidhur me konstatimin: *“Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve personale nëpërmjet publikimit të politikave të privatësisë në faqen zyrtare”*, Kontrolluesi argumenton: *“Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se, për shkak të problemeve të licensimit, sistemi informatik i kompanisë është i bllokuar, ndaj website dhe posta elektronike e shoqërisë “Albpetrol Sh.A.” nuk funksionon. Sistemi informatik i shoqërisë është hackeruar ndaj aksesimi i tij është i pamundur. Kjo çështje është duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ndaj është çështje nën hetim. Për sa më sipër rekomandimi për publikimin e politikave të privatësisë në faqen zyrtare është i pamundur të përmbushet praktikisht nga ana e Kontrolluesit subjektit “Albpetrol Sh.A.””*

Sa i përket këtij argumenti, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se, sikurse është konstatuar gjatë hetimit (objekt i të cilit është verifikimi i zbatimit të detyrimeve të lëna në Rekomandim), po ashtu edhe provave të paraqitura në seancë dëgjimore, rezulton se në përmbajtje të shkresave nr.3442 Prot., datë 27.04.2022 dhe nr.3552 Prot., datë 29.04.2022, nuk përmendet incidenti në lidhje me faqen zyrtare të institucionit, por bllokimi i shërbimeve të Exchange Server që ka pamundësuar aksesin e postës elektronike si dhe bllokimi i disa kompjuterave të punonjësve të shoqërisë, të cilat kanë ndodhur në datën 26.04.2022.

Pavarësisht sa më sipër, Rekomandimi nr. 21/2020 i Komisionerit për Kontrolluesin *“Albpetrol SH.A.”*, ka dalë në përfundim të procedurës së hetimit administrativ (në zbatim të Urdhrit nr. 92 të Komisionerit, datë 10.06.2020). Përmbushja e detyrimit në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet publikimit të Politikës së

Privatësisë në faqe, në zbatim të nenit 18 të ligjit, duhej të ishte kryer brenda afatit 15 ditor nga data e marrjes dijeni të këtij akti (referuar pikës 9 të këtij rekomandimi. Në vijim, *“Albpetrol SH.A.” duhej të njoftonte Zyrë e Komisionerit për masat e marra, në përmbushje të detyrimeve pasuese të këtij Rekomandimi*}, gjë e cila nuk ka ndodhur.

- Lidhur me konstatimin se *“Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përfshirjen e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit”*, Kontrolluesi argumenton se, *“Në lidhje me këtë gjetje sqarojmë se mbetet e porealizuar pasi Kontrolluesi “Albpetrol SH.A.” kërkon të asistohet mbi mënyrën se si duhet të përcaktohet Përpunuesi.”*

Sa i përket këtij argumenti, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se, përcaktimi i rolit të përpunuesit është i qartë, referuar përcaktimeve në pikën 7 të nenit 3 të ligjit: *“Përpunues është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit.”*

- Lidhur me konstatimin se *“...nuk janë marrë masa në lidhje me përditësimin e Njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit...”*, Kontrolluesi argumenton se *“Në lidhje me këtë gjetje sqarojmë se mbetet e porealizuar pasi Kontrolluesi subjekti “Albpetrol SH.A.”, kërkon të asistohet mbi mënyrën se si duhet të kryhet njoftimi pranë Komisionerit. Gjithashtu kërkohet informacion në lidhje me periodicitetin e këtij raportimi”*.

Sa i përket këtij argumenti, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se, sikurse është parashikuar në pikën 1 të nenit 21 të ligjit, *“Njoftimi”* duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

- Lidhur me konstatimin se *“...Kontrolluesi nuk ka marrë masa në lidhje me hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në përputhje me veprimtarinë dhe proceset përpunuese që kryen...”*, Kontrolluesi argumenton se *“Në lidhje me këtë gjetje, sqarojmë se subjekti Kontrollues “Albpetrol SH.A.”, është në proces të hartimit të Rregullores së re mbi të cilën organizohen drejtoritë dhe funksionet në bazë të Urdhrit nr. 27 datë 01.02.2022. Gjithashtu sjellim në vëmendje se së fundi shoqëria është përballur me një situatë të paprecedente të ndryshimit të shpeshhtë të menaxhmentit, që ka krijuar mungesë stabiliteti në staf dhe jemi gjendur në kushte të paditurisë mbi përfshirjen e këtij neni në Rregullore”*.

Sa i përket këtij argumenti, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë për arsye se, përmbushjen e detyrimit në lidhje me hartimin e rregullores, duhej të ishte kryer brenda afatit 15 ditor nga data e marrjes

dijeni të Rekomandimit (referuar pikës 9 të tij). Në vijim, “Albpetrol SH.A.” duhej të njoftonte Zyrën e Komisionerit për masat e marra, në përmbushje të detyrimeve pasuese të Rekomandimit, gjë e cila nuk ka ndodhur.

- Lidhur me konstatimin se “...Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale...”, Kontrolluesi argumenton se “Në lidhje me këtë gjetje, kemi kryer identifikimin e nevojave për trajnim për punonjësit e shoqërisë “Albpetrol SH.A.”, jemi duke negociuar me organizata te licencuara mbi trajnimin e punonjësve që duhet të kenë akses dhe të përpunojnë të dhënat personale”.

Sa i përket këtij argumenti, Zyra e Komisionerit vlerëson se e, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. si dhe duhet të kryhen me qëllim ndërgjegjësimit e operatorëve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, pika 1, geramat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) Kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

b) Kontrolluesit, ose përpunuesi që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

ç) Kontrolluesit, ose përpunuesi që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mos përmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me mungesën garantimit të parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 32 (pika 1), 39 (pika 1, germat “a”, “b”, “ç”, “d”, “dh”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

## **V E N D O S A:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit.
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit.
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit.
4. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit.
5. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit.
6. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, Kontrolluesi të përmbushë detyrimet e lëna në Rekomandimin nr. 21, datë 30.07.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
7. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
8. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 04.11.2022.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**